

Prof. As. Dr. Besnik Çerekja ka përfunduar gjimnazin “Kostandin Kristoforidhi” në Elbasan me notë mesatare 9.7/10.

Në vitin akademik 2003-2004 ka përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Romës “La Sapienza”, Itali, duke mbrojtur tezën me titull: “Masat personale të sigurisë” në lëndën e Të Drejtës Procedurale Penale me notë përfundimtare 93/110.

Në nëntor të vitit 2004 ka marrë pjesë në kursin e kualifikimit (i çertifikuar) mbi “Të drejtën e Emigracionit në Itali” organizuar nga shoqëria “STRANIERIITALIA.IT”

Gjatë vitit akademik 2004-2005, ka kryer studimet master mbi të “Drejtat e të Miturve” pranë Universitetit të Romës “La Sapienza”, duke mbrojtur tezën me titull: “Ndërmjetësimi në krimet e të miturve”, me vlerësim përfundimtar 110/110 me lavdërim.

Pas një pune të gjatë kërkimore ka marrë Gradën Shkencore “Doktor Shkencash” pranë Departamentit Penal në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës dhe në prill të vitit 2015, ka marrë Titullin Akademik “Prof. Asoc” në fushën e së drejtës penale pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.

Ai është autor i disa referateve shkencore të mbajtura në konferenca shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe i disa botimeve shkencore të publikuara në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit, duke marrë pjesë gjithashtu edhe në tryeza mbi diskutimet e Reformës në Drejtësi.

Më datë 01.05.2004 ka filluar punë si asistent avokat në zyrën avokatore të Av. Massimo Pisani në Romë me të cilën, që prej vitit 2003, kishte marrdhënie pune lidhur me aktivitetin e tij si përkthyes i gjuhës italiane.

Që prej nëntorit të vitit 2005 ka filluar punë si Pedagog i brendshëm në Departamentin e të Drejtës Penale, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, pranë të cilit vazhdon të japë kontributin e tij.

Nga Janari i vitit 2006 deri në tetor të vitit 2008 ka punuar si përkthyes zyrtar (i jashtëm) për gjuhën italiane pranë Ministrisë së Drejtësisë në Shqipëri.

Në shkurt të vitit 2006 ka marrë titullin për ushtrimin e profesionit të avokatit në Shqipëri dhe që prej asaj periudhe ushtron profesionin e avokatit, duke përfaqësuar në gjykim kryesisht çështje penale, civile, kontraktore dhe tregtare. Që prej muajit janar 2014, ka marrë të drejtën e përfaqësimit në gjykim për të tre shkallët e gjyqimit.

Gjatë periudhës Mars 2012 – Qershor 2016 ka shërbyer si Zëvendës Dekan i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.

Ai njihet në mënyrë perfekte gjuhën italiane dhe atë angleze.